

## Qëllimi

Ky dokument ju jep informacionin kryesor për këtë produkt investimi. Nuk është material marketingu. Informacioni kërkohet nga ligji për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën, rreziqet, kostot, fitimet dhe humbjet e mundshme të këtij produkti, dhe t'ju ndihmojë ta krahasoni me produktet e tjera.

## Produkt

### MS 40

një nënfond i **Eurizon Manager Selection Fund**

**Klasa e Kuotës: R (EUR Accumulation, ISIN: LU0256013359)**

**Shoqëria Administruese:** Eurizon Capital S.A., një kompani që i përket Grupit Bankar Intesa Sanpaolo

**Faqja e internetit:** [www.eurizoncapital.com](http://www.eurizoncapital.com)

**Për informacione të tjera, telefononi në:** +352 49 49 30 - 323

Commission de Surveillance du Secteur Financier (CSSF) është përgjegjës për mbikëqyrjen e Shoqërisë Administruese në lidhje me këtë dokument të informacionit kryesor

Ky produkt është i autorizuar në Luksemburg.

Eurizon Capital S.A. është i autorizuar në Luksemburg dhe i rregulluar nga Commission de Surveillance du Secteur Financier (CSSF).

**Data e prodhimit të këtij dokumenti kryesor të informacionit: 19 shkurt 2025**

## Çfarë është ky produkt?

### Lloji

Ky produkt është një Klasë Kuotash e nënfondit MS 40 ("Fondi") i cili është pjesë e Eurizon Manager Selection Fund, një fond i hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm (FCP) që kualifikohen si SIKTT.

### Afati

Nuk ka asnjë datë maturimi për këtë produkt. Produkti mund të mbyllet në mënyrë të njëanshme ose të bashkohet me një tjetër pas njoftimit për investitorët në kushtet e paraqitura në Prospekt.

### Objektivat

**Objekti i investimit** Të rrisë vlerën e investimit tuaj me kalimin e kohës.

40% JP Morgan Economic dhe Monetary Union (EMU) Index + 40% MSCI World Index (kthimi total neto) + 20% FTSE MTS Italy BOT – Ex-Bank of Italy. Për krijimin e portofolit dhe matjen e performancës.

**Politika e investimit** Fondi investon kryesisht, në proporcion të balancuar, në tituj dhe në obligacione qeveritare dhe të korporatave të shprehura në euro. Këto investime mund të jenë nga kudo në botë dhe disa prej tyre mund të jenë nën nivelin e investimit. Fondi kryesisht investon përmes fondeve, por gjithashtu mund të investojë drejtpërdrejt ose përmes derivateve.

Konkretisht, fondi investon të paktën 51% të aktiveve neto në UCITS ose UCIs të tjera. Fondi investon në borxh dhe instrumente të lidhura me borxhin, duke përfshirë instrumentet e tregut të parasë, dhe në kapitale dhe instrumente të lidhura me kapitalin, përfshirë obligacionet e konvertueshme.

Fondi mund të investojë në kategoritë e mëposhtme të aktiveve deri në përqindjet e treguara të totalit të aktiveve neto:

■ tituj kapitali dhe instrumente të lidhura me titujt e kapitalit: 50%, minimumi 30% (afërsisht 40% mesatarisht)

■ instrumente borxhi nën kategorinë investuese ose të paklasifikuara 49% Derivatvët dhe teknikat Fondi mund të përdorë derivativë për reduktimin e rreziqeve (mbulimi) dhe të kostove, si dhe për të arritur ekspozim të shtuar të investimit.

**Strategjia** Për administrimin aktiv të fondit, menaxheri i investimeve përdor analizën makroekonomike së bashku me analizën sasiore dhe cilësore për të përshtatur në mënyrë dinamike grupin e aktiveve të portofolit dhe ekspozimin gjeografik dhe për të zgjedhur investimet (qasja nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart). Ekspozimi i fondit ndaj letrave me

vlerë, dhe rrjedhimisht performanca e tij, ka gjasa të ndryshojë pak nga ato të indeksit referencë.

**Politika e shpërndarjes** Kjo Klasë Kuotash nuk shpërndan dividendë. Të ardhurat nga investimet riinvestohen.

**Informacione të tjera** Fondi ka karakteristika mjedisore (E) dhe sociale (S) dhe nxit investimin në aktive që respektojnë praktikën e qeverisjes së mirë (G), në përputhje me nenin 8 të Rregullores për Publikimin e Financave të Qëndrueshme ("SFDR"). Për më shumë informacion, shihni "Politika për Investimet e Qëndrueshme dhe Integrimi i Kriteve ESG" në Prospektin e disponueshëm në faqen tonë të internetit në <https://www.eurizoncapital.com/pages/sustainability.aspx> ose në ambientet e shpërndarësve.

### Investitori individ i synuar

Fondi është i disponueshëm për investitorët që kanë njohuri bazë, me ose pa këshillim.

Fondi synon investitorët që i kuptojnë risqet e fondit dhe planifikojnë të investojnë përtej periudhës së rekomanduar të mbajtjes 5 vjeçare.

Fondi mund të tërheqë investitorët që janë në kërkim të një investimi që kombinon të ardhurat dhe rritjen, dhe janë të interesuar për ekspozimin ndaj përzjerjes së aktiveve të diversifikuara, qoftë për një investim bazë ose për qëllime diversifikimi.

### Informacione praktike

**Depozitari** Depozitari i fondit është State Street Bank International GmbH, Dega e Luksemburgut.

**Informacione të mëtejshme** Për informacion të mëtejshëm rreth kësaj Klase Kuotash ose ndonjë Klase Kuotash tjetër të këtij fondi ose fondeve të tjera të FCP-së, ju mund t'i referoheni Prospektit (në të njëjtën gjuhë si KID), Rregullores të Menaxhimit ose raportit financiar gjashtëmujor ose vjetor më të fundit të disponueshëm (në anglisht). Këto dokumente përgatiten për të gjithë FCP-në dhe mund të merren në çdo kohë, pa pagesë, duke vizituar faqen e internetit të Shoqërisë Administruese në [www.eurizoncapital.com](http://www.eurizoncapital.com) ose duke i dërguar një kërkesë me shkrim Shoqërisë Administruese ose depozitarit.

**Publikimi i çmimit** Vlera neto e aktiveve të kësaj Klase Kuotash publikohet çdo ditë në faqen e internetit të Shoqërisë Administruese në [www.eurizoncapital.com](http://www.eurizoncapital.com).

## Cilat janë rreziqet dhe çfarë mund të marr në këmbim?

### Rreziket



Treguesi përmbledhës i rrezikut është një udhëzues për nivelin e rrezikut të këtij produkti në krahasim me produktet e tjera. Tregon se sa gjasa ka

### Skenarët e performancës

Shifrat e paraqitura përfshijnë të gjitha kostot e vetë produktit, por mund të mos përfshijnë të gjitha kostot që i paguani këshilltarit ose shpërndarësit tuaj. Shifrat nuk marrin parasysh situatën e tatimeve tuaja personale, gjë që mund të ndikojë gjithashtu në shumën që do të përfitoni.

**Ajo çfarë do të përfitoni nga ky produkt varet nga performanca e ardhshme e tregut. Zhvillimet e tregut në të ardhmen janë të pasigurta dhe nuk mund të parashikohen me saktësi.**

**Skenarët e pafavorshëm, të moderuar dhe të favorshëm të paraqitur, janë ilustrime që përdorin performancën më të keqe, mesatare dhe më të mirë të produktit/ një treguesi referencë të përshtatshëm gjatë 10 viteve të fundit. Tregjet mund të zhvillohen shumë më ndryshe në të ardhmen.**

Skenari i stresit tregon se çfarë mund të përfitoni kur tregu është në kushte ekstreme.

**E pafavorshme:** ky lloj skenari ka ndodhur për një investim midis mars 2015 dhe mars 2020.

**I moderuar:** ky lloj skenari ka ndodhur për një investim midis qershor 2019 dhe qershor 2024.

**E favorshme:** ky lloj skenari ka ndodhur për një investim midis tetor 2016 dhe tetor 2021.

Periudha e rekomanduar e mbajtjes		5 vite	
Shembull Investimi		10.000 EUR	
Skenarët		nëse dilni pas 1 viti	nëse dilni pas 5 vitesh (periudha e rekomanduar e mbajtjes)
<b>Minimumi</b>	<b>Nuk ka asnjë kthim minimal të garantuar. Ju mund të humbni një pjesë ose të gjithë investimin tuaj.</b>		
<b>Stresi</b>	<b>Çfarë mund të marrësh mbrapsht pas kostove</b> Kthimi mesatar çdo vit	<b>6.570 EUR</b> -34,28%	<b>6.960 EUR</b> -6,99%
<b>E pafavorshme</b>	<b>Çfarë mund të marrësh mbrapsht pas kostove</b> Kthimi mesatar çdo vit	<b>8.320 EUR</b> -16,82%	<b>9.960 EUR</b> -0,07%
<b>I moderuar</b>	<b>Çfarë mund të marrësh mbrapsht pas kostove</b> Kthimi mesatar çdo vit	<b>10.160 EUR</b> 1,65%	<b>11.270 EUR</b> 2,42%
<b>E favorshme</b>	<b>Çfarë mund të marrësh mbrapsht pas kostove</b> Kthimi mesatar çdo vit	<b>11.590 EUR</b> 15,92%	<b>12.560 EUR</b> 4,66%

## Çfarë ndodh nëse Eurizon Capital S.A. nuk është në gjendje të paguajë?

Nëse fondi nuk është në gjendje t'ju paguajë shumën që duhet t'ju paguajë, ju mund të humbni të gjithë investimin tuaj. Nuk parashikohet garanci e investimit dhe skemë kompensimi në këtë rast. Fondi trajtohet si një njësi e veçantë që ka aktivet e veta, të cilat janë të dallueshme në të gjitha aspektet nga aktivet e shoqërisë Administruese dhe aktivet e secilit prej investitorëve të tjerë në fond, si dhe nga aktivet e çdo produkti tjetër të menaxhuar nga Shoqëria Administruese. Për detyrimet e kontraktuara në emër të një produkti specifik, Shoqëria Administruese do të jetë përgjegjëse ekskluzivisht për aktivet e produktit në fjalë. Mbi aktivet e fondit, nuk duhet të lejohen veprime të kreditorëve të Shoqërisë Administruese ose të kreditorëve që veprojnë në bazë të interesit të saj, as veprime të kreditorëve të depozitarit ose nëndepozitarit ose kreditorëve që veprojnë në interes të depozitarit ose nëndepozitarit. Veprimet e kreditorëve të një investitori në fond kufizohen në pozicionet e mbajtura në fond nga investitori përkatës. Shoqëria administruese nuk mund të përdorë në asnjë rrethanë aktivet e fondit për interesat e saj ose të palëve të treta.

## Cilat janë kostot?

Personi që ju këshillon ose ju shet këtë produkt mund t'ju ngarkojë me kosto të tjera. Në këtë rast, ky person do t'ju japë informacion në lidhje me këto kosto dhe se si ato ndikojnë në investimin tuaj.

### Kostot me kalimin e kohës

Tabelat tregojnë shumat që merren nga investimi juaj për të mbuluar lloje të ndryshme kostosh. Këto shuma varen nga sasia që investoni, sa kohë e mbani produktin dhe sa mirë funksionon produkti. Shumat e paraqitura këtu janë ilustrime të bazuara mbi një shumë investimi shembull dhe periudhave të ndryshme të mundshme investimi.

Ne kemi supozuar:

- në vitin e parë do t'ju kthehet shuma që keni investuar (0% kthim vjetor). Për periudhat e tjera të mbajtjes ne kemi supozuar se produkti funksionon si tregohet në skenarin e moderuar,
- janë investuar 10.000 EUR.

Shembull Investimi 10.000 EUR	nëse dilni pas 1 viti	nëse dilni pas 5 vitesh (periudha e rekomanduar e mbajtjes)
<b>Kostot totale</b>	<b>340 EUR</b>	<b>1.154 EUR</b>
<b>Efekti* i kostos vjetore</b>	<b>3,5%</b>	<b>2,2% cdo vit</b>

(\* ) Kjo ilustron se si kostot reduktojnë kthimin tuaj çdo vit gjatë periudhës së mbajtjes. Për shembull, tregon se nëse dilni në periudhën e rekomanduar të mbajtjes, kthimi mesatar në vit parashikohet të jetë 4,60% përpara kostove dhe 2,42% pas kostove.

Ne mund të ndajmë një pjesë të kostove me personin që ju shet produktin për të mbuluar shërbimet që ata ju ofrojnë juve. Ata do t'ju informojnë për shumën.

## Përbërja e kostove

Kostot fillestare në hyrje ose dalje		Ndikimi i kostos vjetore nëse dilni pas 1 viti
<b>Kostot hyrëse</b>	<b>1,50%</b> e shumës që paguani kur hyni në këtë investim. Kjo është shuma maksimale që do të tarifohet. Personi që ju shet produktin do t'ju informojë për tarifën aktuale.	<b>Deri në 150 EUR</b>
<b>Kostot dalje</b>	<b>0,00%</b> , ne nuk marrim tarifë daljeje për këtë produkt.	<b>0 EUR</b>
Kosto të vazhdueshme që mbahen çdo vit		Ndikimi i kostos vjetore nëse dilni pas 1 viti
<b>Tarifat e menaxhimit dhe kosto të tjera administrative ose operative</b>	<b>1,92%</b> të vlerës së investimit tuaj në vit. Ky është një vlerësim i bazuar në kostot aktuale gjatë vitit të kaluar.	<b>189 EUR</b>
<b>Kostot e transaksioneve</b>	<b>0,01%</b> të vlerës së investimit tuaj në vit. Ky është një vlerësim i kostove të bëra kur blejmë dhe shesim investimet bazë për produktin. Shuma aktuale do të ndryshojë në varësi të sasisë që blejmë dhe shesim.	<b>1 EUR</b>
Kosto të rastësishme që mbahen në kushtetë vecanta		Ndikimi i kostos vjetore nëse dilni pas 1 viti
<b>Tarifa e performancës</b>	Nuk ka tarifë performance për këtë produkt.	<b>0 EUR</b>

## Sa gjatë duhet ta mbaj dhe a mund të marr para më herët?

### Periudha e rekomanduar e mbajtjes: 5 vite

Nëse do ti shisni njësitë tuaja përpara përfundimit të periudhës së rekomanduar të mbajtjes, kjo mund të ndikojë në profilin e rrezikut dhe/ose në performancën e investimit tuaj.

Kërkesat për blerjen, shkëmbimin ose shitjen e kuotave të fondit që merren dhe pranohen nga agjenti transferues deri në orën 16:00 CET të çdo dite që është një ditë pune në Luksemburg përpunohen zakonisht ditën pasuese të punës.

## Si mund të ankojem?

Ankesat mund të dorëzohen ose me shkrim në Eurizon Capital S.A., 28, boulevard de Kockelscheuer, L-1821 Luksemburg, në vëmendje të Compliance & AML, ose të dërgohen me faks në numrin +352 494 930 349, ose nëpërmjet seksionit "Contacts" në faqen e internetit të Eurizon Capital S.A. (www.eurizoncapital.com). Ankesat mund të merren gjithashtu nga Shoqëria Administruese nëpërmjet shpërndarësve të saj të autorizuar. Shoqëria Administruese duhet t'i trajtojë të gjitha ankesat me kujdesin, transparencën dhe objektivitetin më të madh dhe duhet t'i komunikojë me shkrim investitorit, në një gjuhë të thjeshtë dhe lehtësisht të kuptueshme dhe me anë të një mënyre komunikimi të regjistruar me konfirmim marrjeje, vendimin e saj brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës. Për informacion shtesë, ju lutemi referojuni seksionit "Investor's Rights" të faqes së internetit të Eurizon Capital S.A. (www.eurizoncapital.com).

## Informacione të tjera të rëndësishme

**Skenarët e performancës** Skenarët e mëparshëm të performancës mund t'i gjeni të përditësuar çdo muaj në www.eurizoncapital.com.

**Performanca e mëparshme** Ju mund të shkarkoni performancën e kaluar gjatë 10 viteve të fundit nga faqja jonë e internetit në www.eurizoncapital.com.